

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ /07/2026

LËNDA: PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE**

I mbajtur sot në datë 06.07.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, person përgjegjës, i emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit Nr. 451/3 Prot, datë 06.07.2026 për procedurën e prokurimit me objekt: “Konfigurim dhe integrimi i Scadës Lokale të 14 Nënstacioneve në SCADË-n qendrore”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Panele Kontrolli 31211110-2. Kabllo dhe pajisje telekomunikacioni 32520000-4.

Vlera e fondit limit: 126,494,900.00 (Njëqind e njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind lekë) lekë pa TVSH ose **(1,342,975.90 EUR (një milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë cent EUROS)** euro excluding VAT) euro pa TVSH. Kursi kembimit sipas Bankës së Shqiperisë i datës 06.07.2026 është 94.19 (nëntëdhjetë e katër pikë nëntëmbëdhjetë).

Fondi limit është percaktuar me studim tregu duke kërkuar oferta nga kompani që kanë eksperiencë bashkepunimi me kompanitë e huaja në projekte në Sistemin Energjitik Shqiptar, për punime dhe furnizime të ngjashme, sepse në projektet e huaja, cmimet janë komplekse, dhe përfaqësojnë shumë materiale ndihmëse dhe është e vështirë të nxjerrësh cmime reference për pajisjet e duhura si njësi.

Bashkëlidhur janë dokumentacioni teknik i detajuar për këtë projekt, preventivi përkatës, grafiku i levimit, kriteret kualifikuese, kërkesat për ofertat dhe ofertat përkatëse etj.

Afati për zbatimin e kontratës (furnizim pasjisje/furnizim kabllo & instalim rrjet fuqie, kontrolli dhe LAN/ router, Firewall/programim/licenca dhe konfigurim, etj.) do të jetë 16 muaj nga data e nënshkrimit të saj.

Baza ligjore për zhvillimin e procedurës

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Zhvillimi i kësaj procedure të prokurimit mbështetet në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, si më poshtë:

- Neni 33, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton përdorimin e procedurës së hapur për blerjen e mallrave, shërbimeve ose punëve mbi kufirin e lartë monetar;
- Neni 40 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili rregullon zhvillimin e procedurës së hapur mbi kufirin e lartë monetar për mallra, duke garantuar transparencë, konkurrencë dhe zbatim të drejtë të parimeve të ligjit;
- Neni 3 i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet bazë të prokurimit publik, si transparenca, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe përdorimi efikas i fondeve publike.

Për argumentimin e fondit limit grupi i punës i caktuar me urdher të titullarit të Ak-se, j’u referuan studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- d) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në zbatim të Nenit 39 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar me kujdes mundësinë e ndarjes së procedurës së prokurimit në lote dhe ka arritur në përfundimin se ndarja në lote nuk është e përshtatshme për këtë objekt prokurimi.

Objekti i procedurës “Konfigurim dhe integrimi i SCADA-s lokale të 14 nënstacioneve në SCADA-n qendrore” përfaqëson një sistem të integruar, teknikisht kompleks dhe funksionalisht të ndërlidhur, i cili synon garantimin e komunikimit, monitorimit dhe kontrollit të unifikuar midis nënstacioneve dhe qendrës së dispeçerimit.

Nënstacionet objekt i këtij projekti (110/20 kV Tirana 1 (Zogu i Zi), 110/35/20/10/6 kV Kuçovë, 110/20/10 kV Xarë, 110/35/20 kV Himarë e Re, 110/35/20 kV Orikum i Ri, 110/35/20 kV Velipojë, 110/20 kV Fier 2, 110/20/10 kV Piqeras, 110/35/20 kV Arkëri, 110/35/6 kV Kafaraj, 110/10 kV Leskovik, 110/35/10 kV Çorovodë, 110/35/20/10 kV Pogradec dhe 110/20/10 kV Lezhë) janë pjesë e të njëjtit sistem operativ dhe funksional të menaxhimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Ndarja e kësaj procedure në lote do të krijonte rrezik të lartë për:

- **moskoordinim teknik ndërmjet sistemeve SCADA të instaluar nga operatorë të ndryshëm;**
- **mospërputhje në protokollet e komunikimit dhe integritetit me SCADA qendrore;**
- **vështirësi në garantimin e ndërveprueshmërisë (interoperabilitetit) dhe standardizimit të sistemit;**
- **rritje të ndjeshme të rrezikut operacional dhe të ndërprerjeve në sistemin e monitorimit dhe kontrollit;**
- **ndarje të përgjegjësisë kontraktore në rast defektesh apo mosfunksionimi të sistemit të integruar.**

Duke qenë se SCADA është një sistem kritik për operimin në kohë reale të rrjetit elektrik, çdo fragmentim i përgjegjësisë midis operatorëve të ndryshëm do të cenonte sigurinë, vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimit publik të furnizimit me energji elektrike.

Për më tepër, unifikimi i furnizimit, konfigurimit dhe integritetit të sistemit në një kontratë të vetme garanton:

- përgjegjësi të qartë dhe të unifikuar të kontraktorit;
- standardizim të plotë teknik;
- implementim të koordinuar dhe të sinkronizuar të sistemit në të gjitha nënstacionet;
- ulje të riskut të vonesave dhe konflikteve ndërmjet kontraktorëve.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ndarja në lote nuk është në përputhje me natyrën teknike dhe funksionale të objektit të prokurimit dhe nuk do të siguronte përdorimin

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

efikas, ekonomik dhe të sigurt të fondeve publike, në përputhje me parimet e ligjit të prokurimit publik.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
 - f) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
- Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria e Tensionit të Lartë**

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

OSSH sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: *“3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit të lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve (2023, 2024, 2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit . Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoriteti tatimorë kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

3. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë shlyer detyrimet financiare të taksave vendore të parashikuara nga Njësia/të e Pushtetit Vendor për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026, referuar ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në të cilën/at janë regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi. Dokumentet provuese / vërtetimet të / e kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:*

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme, e cila duhet të vërtetohet nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2. Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

- a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët duhet

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune,
- Diplomën Universitare,
- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Drejtuksi teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dy punësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë staf teknik inxhinier (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) dhe punonjës të specializuar/kualifikuar e ndihmes mesatarisht jo me pak se 11 punonjes si më poshtë:

- Inxhinier Elektrik 2 (dy)
- Elektriciste 5 (pese)
- Punetore ndihmes 4 (kater)

Për punonjësit me profesionet si më sipër (përfshirë inxhinierët) , operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
3				

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

4				
5				

Për stafin teknik inxhinier si më sipër, ofertuesit duhet të paraqesin :

- Kontratë pune/
- Diplomën Universitare,
- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Për punonjesit e kualifikuar elektrikistë:

- Kontratë pune
- Certificate trajnimi
- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Për punonjesit ndihmes:

- Kontratë pune
- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.2 – a. Kërkesat e pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe nevojave për realizimin e punimeve. Numri i inxhinierëve, dhe punonjesve është kërkuar duke parë objektin e furnizimit dhe grafikun e punimeve të keture furnizimeve, të cilat mund të kryhen në më shumë se një N.Stacion, në të njëjtën kohë.

Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për realizimin me sukses të objektit të furnizimit të SCADA për 14 N.Stacionet e këtij furnizimi sipas listës në Relacionin Teknik.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Elektricitet janë te nevojshem që nën drejtimin e stafit inxhinierik elektrik, të ndihmojnë instalimin dhe montimin e paneleve SCADA në N.Stacione duke kryer punët përgatitore për vendosjen e plote në punë të pajisjeve.

Nga keta 3 punonjës të kësaj kategorie IV ose më lart, dhe pjesa tjetër të pajisur me certifikate trajnimit leshuar nga OMVK.

Puntoret ndihmes janë te nevojshem që nën drejtimin e stafit inxhinierik elektrik, dhe elektricistëve të kryejnë punët përgatitore për vendosjen e plote në punë të pajisjeve.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar, 2 inxhinierë elektrik, 1 (një) inxhinier elektrike i certifikuar për instalimin, konfigurimin dhe komisionimin e sistemit SCADA dhe 1 inxhinier elektrik të certifikuar për instalimin, konfigurimin dhe komisionimin e pajisjeve Router / Firewall nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i pajisjeve për këtë objekt furnizimi.

Lidhur me këtë pikë OE i klasifikuar i pari duhet të paraqesë:

- kontratën e individuale të punës
- diplomën universitare.
- çertifikatat perkatese për realizimin e kërkesave të mesipërme.

Argumentim: Integrimi i SCADA lokale të 14 N.Stacioneve të rinj me SCADA Qendrore në Tiranë është i rëndësishëm sepse monitoron online këto N.Stacione njëkohësisht në dy vende, N.Stacioni elektrik perkates dhe në Qendrën Dispecer ku SCADA monitoron 24/7 në kohe reale të gjithë N.Stacione e integruar në të, duke rritur në këtë mënyrë sigurinë në punë të tij.

Inxhinierët elektrike të certifikuar për programimin dhe konfigurimin e SCADA-s dhe Router/Firewall janë të rëndësishëm sepse një gabim ose pakujdesi e vogël mund të shkaktojë ndërprerje masive të energjisë elektrike ose demtim të pajisjeve në N.Stacion.

Roli inxhinierëve elektrik të certifikuar është specifik sepse përfshin:

- Konfiguron SCADA-n të komunikojë me reletë mbrojtëse inteligjente. Në rast mbingarkese apo lidhjeje të shkurtër, sistemi duhet të sinjalizojë dhe veprime për izolimin e defektit në milisekonda.
- Komandimi i çelësve të fuqisë, nepermjet programimit garanton që manovrimi i çelësve të fuqisë të bëhet sipas radhës dhe logjikes së saktë të veprimit, për të shmangur veprime të rrezikshme elektrike në rradhe të pare ndaj stafit operativ të N.Stacioneve por edhe në sigurinë e pajisjeve elektrike të tij.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Siguri Teknike te N.Stacionit dhe Kibernetike nga rrjeti.
 - ✓ **Bllokimet Logjike (Interlocking):** Inxhinieri programon algoritme që ndalojnë operatorin të bëjë gabime fatale (p.sh. hapja e një ndarësi nëse çelësi i fuqisë është ende i mbyllur).
 - ✓ **Mbrojtja e Rrjetit:** Nënstationet janë shënjestra të sulmeve kibernetike, inxhinieri është i aftë që të sigurojë që pajisjet e sistemit SCADA janë të izoluar në rrjete të mbrojtura dhe me akses të kriptuar.

Per sa me siper kërkesa për inxhinieret elektrik të certifikuar per instalimin, konfigurimin dhe komisionimin e SCADA dhe pajisjeve Router/Firewall është një kërkesë teknike e nevojshme për të garantuar që pajisjet e furnizuara kane staf te afte profesionalisht ne rast nevojje sherbimi apo service te tyre gjate furnizimit por edhe periudhes se garancise.

2.3.4. Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë, për periudhën tre muajve të fundit nga data e shpalljes.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajve të fundit nga data e shpalljes.

Argumentimi 2.3.4 Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore si pjesë të përvojës së shoqërisë, përvojë kjo e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit, pasi fakti që shoqëria disponon personel të kualifikuar në vijimësi, tregon aftësi të larta profesionale dhe mundësi të mira për organizimin e punës dhe zbatimin me sukses të kontratave që do të lidhen gjatë zbatimit të MK.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Kriteri sipas pikës 2.3.4, të kapacitetit teknik, ku kërkohet që punonjësit të jenë pjesë e shoqërisë për një periudhë tre mujore, vlerësohet në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe në funksin të përzgjedhjes së OE që zotërojnë aftësinë teknike dhe profesionale për zbatimin e kontratës.

2.3.5. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt me emërtesën e artikullit në të cilën duhet të deklarojnë të dhënat e kërkuara, sipas Skedes Teknike të mëposhtme:

Tabela e Skedes Teknike te pajisjeve te kerkuara dhe ato te ofruar nga operatoret ekonomik.

Nr.	Emertimi i pajisjeve	Kompania Prodhuese e artikullit të ofruar	Referenca për specifikimet teknike sipas katalogëve të artikullit të ofruar
1.	• Pajisje SCADA		
2.	• Router/Firewall industrial i menaxhueshem i kompletuar		
3.	• Laptop per testimin konfigurimin e protokolleve IEC 61850 dhe 60870-5-104 me licensat e perfshira. konfigurimin e pajisjeve te sistemit SCADA		

Argumentimi 2.3.5. Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave objekt i furnizimit. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi specifikime teknike: Në dokumentacionin Teknik për realizimin e këtij projekti janë bashkëlidhur dokumentet me emërtimin “**Relacioni Teknik Konfigurim dhe integrim i SCADA lokale te 14 N.Stacioneve me SCADA Qendrore**” ku në Kapitullin 9, fq. 36, "Specifikime teknike të pajisjeve” janë paraqitur specifikimet teknike të detajuara për mallrat pjesë e kësaj

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

procedure sipas skedes teknike dhe ne dokumentin tjetër bashkëlidhur po kësaj procedure me emërtimin **“Skeda Teknike Konfigurim dhe integrim i SCADA lokale te 14 N.Stacioneve me SCADA Qendrore”** janë paraqitur specifikimet teknike për mallrat e kërkuar si dhe kollona për tu plotësuar nga Operoret Ekonomik me mallrat e ofertuara.

Për sa i përket specifikimeve teknike janë dhënë të detajuara si përshkruhet më lartë dhe kërkohet nga Operoret Ekonomik të plotësojnë skedën teknike me të dhënat e pajisjeve të ofertuara në mënyrë që ti krijojë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mundësinë për vlerësimin sa më të drejtë lidhur me Operatori Ekonomik ofertues, jo vetëm nga ana ekonomike por edhe teknike. Mendojmë se me informacionin e dhënë për mallrat e kërkuara dhe plotësimi i të dhënave teknike nga Operatori Ekonomik për mallrat e ofruar japim informacionin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për një ofertim sa më të mirë nga ana e tyre.

2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi sipas Skedes Teknike të mesiperme. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

